

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kurti: Identifikohen tri viktime të `Grupit të Intelektualëve`
ADRESA	https://lajmifundit.al/kosoverajon/kurti-identifikohen-tri--te-grupit-te-intelektualeve-i1337930
BURIMI	lajmifundit.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 16:38:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 16:33:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8cfcea2a30d685cdf63bbe8f6f5cb563fce340b994aee826af95d08cd5e94c82
TEKSTI	7b8df0e70fe22d6d4e180330a381881b520ec25c793c673105f9b7c590045041
PAMJA	b616f3ed4aa5ce1fc416a4fa1dbbde513b161d95f153c057012ae4a4dbcdc6e7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bacd8a77fbf5d3f82e55dde1484921ea5fc98150af21734feb041d4a55391390
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	54ed48543a6253cb20faf0026ba4de200ea88d62566e99edbe4b1e5f6894ea0c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bacd8a77fbf5d3f82e55dde1484921ea5fc98150af21734feb041d4a55391390>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [Politike](#)

Kurti: Identifikohen tri viktima të `Grupit të Intelektualëve`


Lexo lajmin e plote



Zbardhet skema e tjetërsimit të pronave në Fier, ekzekutohen 3 urdhëra arresti


Lexo lajmin e plote





Muzeu i Gjirokastrës prezanton Çerçiz Topullin si karikaturë


Lexo lajmin e plote






"Ngeli pa frymë" – Irini Qirjako zbulon aktorin e Hollywood-it që u marros pas saj! Çfarë ndodhi në prapaskenë

Lexo lajmin e plote



One Albania sjell inovacionin Wi-Fi 7 për internetin në shtëpi

Lexo lajmin e plote



Kurti: Identifikohen tri viktima të `Grupit të Intelektualëve`

 Lajmifundit / 19 Shtator 2026, 18:33
Shperndaje
Kosovë&Rajon



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë të ditur se janë pranuar tri raportet e para të ADN-së nga mostrat e mbetjeve mortore të zhvarrosura në lokacionet e varreve masive në Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut.

Kurti ka thënë se analizat e ADN-së më në të dy muajt pas konfirmimit të varrit të narë macit, kanë konfirmuar identitetin e tri viktimave, duke vërtetuar lidhjen me personat e grupit të njohur si

“Grupi i Intelktualëve”, kryesisht qytetarë nga Skenderaj dhe Mitrovica, të rrëmbyer dhe të zhdukur me dhunë më 19 prill 1999 nga forcat serbe.

“Raportet e ADN-së janë ndarë me Institutin për Mjekësi Ligjore dhe mjënjëherë, sot, përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe të Institutit kanë njoftuar familjet e tri viktimave të identifikuara. Në ditët dhe javët në vijim, presim të pranojmë edhe raportet e tjera për mostrat e dërguara për identifikim përmes analizës së ADN-së, me shpresën që edhe familjet e tjera të marrin përgjigjet që presin prej 27 vitesh”, ka shkruar Kurti.

Ai tutje ka thënë se asnjë përgjigje nuk mund ta shuajë dhimbjen e humbjes, por njohja e së vërtetës i jep fund ankthit të pritjes për të mësuar fatin e më të dashurve.

“Më 27 korrik u konfirmua gjetja e varrit masiv në Kalludër. Gjatë vizitës në këtë lokacion, theksova se është jetike që faktorët ndërkombëtarë, me në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar dhe Bashkimin Evropian, të shtojnë tryshninë ndaj Serbisë për zbatimin e Deklaratës për Personat e Zhdukur, të dakorduar më 2 maj 2023 në Bruksel, veçanërisht për hapjen e menjëhershme të arkivave, përfshirë arkivin e Brigadës së 37-të të Motorizuar të Ushtrisë Jugosllave, e cila ka kryer masakra në Kosovë, posaçërisht në Drenicë, dhe dokumentacionin e së cilës Serbia ka klasifikuar në vitin 2014 për një periudhë prej tridhjetë vjetësh”, ka shtuar Kurti.

Tutje kryeministri ka thënë se përkushtimi institucional do të vazhdojë me kërkime në terren, mbështetje për procesin e identifikimit dhe komunikim të drejtpërdrejtë e të kujdesshëm me familjet.

“Do të qëndrojmë pranë tyre dhe do t’i mbështesim në kërkesat për të vërtetën, drejtësinë dhe kthimin me dinjtet të më të dashurve. Zbardhja e fatit të çdo personi të zhdukur me dhunë është prioritet shtetëror i Republikës së Kosovës dhe detyrim njerëzor, që mbetet i hapur për sa kohë qoftë edhe një familje pret përgjigje”, ka nënvizuar Kurti.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.